



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura III

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion
Mbledhja nr. 36/2010

Prishtinë, 01.10.2010, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL

**I mbledhjes së Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport
dhe Telekomunikacion**

Në mbledhje morën pjesë: Myzejene Selmani - kryetare, Ethem Çeku, Sala Berisha – Shala, Adem Grabovci, Kaqusha Jashari, Fatmir Rexhepi, Zef Morina, dhe Adem Salihaj

Munguan: Murselj Haljilji, Mufëra Şinik dhe Qamile Morina.

Pjesëmarrës të tjerë: Imrydin Misini, Hysnije Rexhaj-ZRRE; Haxhi Gashi- USAID; Igballe Rexha-MTI ;Besnik Ramadanaj – KDI dhe Ibrahim Krasniqi konsulent i Komisionit;

Stafi mbështetës: Armend Ademaj, Besim Haliti dhe Muhamet Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Myzejene Selmani, kryetare.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i Procesverbalit të datës 28.09.2010;
3. Shqyrtimi i Projektligjit për Energjinë Elektrike nr. 03-L/201;
4. Shqyrtimi i Projektligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës nr.03-L/229;
5. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Patenta nr.03-L/249;
6. Të ndryshme

Kryetarja konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i Procesverbalit i datës 28.09.2010;

Procesverbalet i mbledhjes 28.09.2010 u miratua pa vërejtje .

3. Shqyrtimi i Projektligjit për Energjinë Elektrike nr. 03-L/201;

Kryetarja –Theksoi se për këtë Projektligj është raportues Ethem Çeku, dhe ja dha fjalën.

Ethem Çeku--Tha që grupi punës e ka për përfunduar punën për projektligjin për energjinë elektrike pas shumë diskutimesh dhe ndërrimesh. Andaj është një Projektligji i mirë, pas shumë vitesh çështja vjedhjes së energjisë elektrike është rregulluar me dispozita ligjore. Ku në rastin e vjedhjes së energjisë elektrike parashihen sanksione dhe dënime të mëdha. Ndërsa kemi pasur qasje të ndryshme rreth ZRRE-së për mënyrën e tenderimit për operatorët energjisë.

Armend Ademaj (Njësia mbështetëse e Komisionit) – kërkoj nga Komisioni që mos të kaloj si i tillë siç është Amendamenti 35 tek Neni 39 sepse aty është vendosur një “Tabelë”. Sipas teknikës së hartimeve të legjislacionit një gjë e tillë nuk është e lejuar andaj propozoj që të përmirësohet dhe përmbajtja e Tabelës të shndërrohet në paragraf të Nenit 39.

Propozimi u miratua nga Komisioni.

Pas debatit të gjerë Komisioni njëzëri nxori këtë

Përfundim

Miratohet Raporti me amendamente i Projektligjit për Energjinë Elektrike nr. 03-L/201 për miratim të mëtutjeshme në Komisionet e përhershme.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës nr. 03-L/229;

Kryetarja–Theksoi se për këtë Projektligj është raportuese Sala Berisha, por ne mungesë të saj, raportin me amendamente e paraqiti, Myzeje Selmani. Shtoj më tej që në këtë

grup punese nuk kishte dhe shumë për të ndërhyre me amendamente. Andaj ne kemi kryere pune si grup punes së bashku dhe me përfaqësuesit e MTI-së dhe Komisionit të Konkurrencës.

Pas debatit të gjerë Komisioni njëzëri nxori këtë

Përfundim

Miratohet Raporti me amendamente i Projektligjit Mbrojtjen e Konkurrencës nr.03-L/229 për miratim të mëtutjeshme në Komisionet e përhershme

5. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Patenta nr.03-L/249;

Kryetarja- tha që në Komision kemi Projektligjin për Patentën, dhe pas informatës nga Njësia përkatëse e Kuvendit mund të rekomandojmë q] ky Projektligj kalojë ne lexim të pare në Kuvend.

Pas debatit të gjerë Komisioni miratoi në parim këtë projektligj dhe njëzëri nxori këtë

Rekomandim

Kuvendi i Kosovës të miratoj në parim Projektligjin për Patenta nr.03-L/249;

6. Të ndryshme

Çështjet vijuese;

Komisioni në mbledhjen e radhës do të shqyrtoj Strategjinë minerare e Republikës së Kosovës për periudhën 2010-2015 dhe Planin për ristrukturimin e Trepçës dhe përgatitjen e saj për tërheqje të investimeve.

Mbledhja përfundoi në orën 13:40

E përgatiti:

Njësia e mbështetjes së Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Myzejene Selmani